

20
VJET

AGJENCIA
E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE

**Depozita të sigurta,
kompensim i garantuar!**

www.asd.gov.al

Çfarë është ASD-ja

Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD) kontribuon në stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri, duke siguruar depozitat e individëve, tregtarëve dhe shoqërive tregtare; duke administruar fondet e sigurimit të depozitave dhe duke kufizuar efektet që falimentimi i një institucioni financiar, pjesë e skemës së sigurimit të depozitave mund të sjellë për depozituesit dhe sistemin financiar. 20 vjet veprimtari e ASD përbën një faktor të rëndësishëm për besimin e publikut se kursimet e tyre janë të sigurta.



2002

- Krijohet Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD).
 - 14 banka anëtare
 - Siguron vetëm individët deri në shumën 700.000 lekë.



2003-2009

- Marrëveshje Bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë.
- Anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave (IADI)
- Anëtare e Forumit European të Siguruesve të Depozitave (EFDI).
- Shuma e kompensimit rritet në 2.500.000 lekë për çdo depozitues individ në çdo bankë të siguruar.



2011

- Organizon aktivitetin e parë të IADI & EFDI për testimin e metodologjisë së vlerësimit të parimeve bazë për një sistem efektiv të sigurimit të depozitave.



2012

- Pjesë e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar.
- Marrëveshje Bashkëpunimi me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë “Për plotësimin e fondeve që i nevojiten ASD në procesin e kompensimit të depozitave të siguruara”.



2016

- Administrator i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme (FNJ).
- Merr çmimin e IADI-t për përmirësimet më të mëdha në sistemin e sigurimit të depozitave.



2017

- Sigurohen depozituesit e shoqërive të kursim-kreditit (shkk).
- Sigurohen depozitat e tregtarëve dhe subjekteve tregtare.



2018

- Marrëveshje Bashkëpunimi me Shoqatën Shqiptare të Bankave (AAB).



2019

- Organizon takimin e 40-të të Komitetit Rajonal të Europës të IADI-t.



2022

- 20 vjet ASD

► Vizioni dhe Vlerat

Bazuar në një eksperiencë 20-vjeçare në administrimin e skemës së sigurimit të depozitave, ASD synon të përmirësojë në vazhdimësi kapacitetet institucionale, për të adresuar me efikasitet sfidat gjithmonë e me komplekse, duke ofruar në këtë mënyrë shërbim cilësor në funksion të stabilitetit financiar dhe sigurimit të depozitave.



Vizion

Të jemi kontribuues dinamikë në sistemin e sigurisë financiare në vend, duke adresuar në kohë dhe me transparencë çështje që lidhen me efektivitetin e skemës së sigurimit të depozitave.





Vlerat

Në këto 20 vjet, ASD ka punuar me angazhim për të ngritur një sistem vlerash, të cilat kanë kontribuar në mbarëvajtjen e performancës së institucionit dhe krijimin e ruajtjen e ndërveprimit efikas me të gjitha grupet e interesit.



Integritet dhe përgjegjshmëri

Veprojmë në përputhje me standardet etike dhe profesionale të institucionit, duke garantuar vendimmarrje profesionale dhe besueshmëri në administrimin e skemës së sigurimit të depozitave.



Përkushtim dhe transparencë

Punojmë me pasion dhe dedikim për arritjen e objektivave institucionale duke siguruar një qasje të hapur dhe nivel të lartë llogaridhënieje të institucionit ndaj depozituesit dhe të gjitha grupeve të interesit.



Puna në grup


Komunikojmë dhe bashkëpunojmë me efektivitet me njëri-tjetrin, duke vlerësuar dhe respektuar vlerat individuale.



► Organizimi i ASD-së

ASD drejtohet nga Këshilli Drejtues, i cili përcakton drejtimit strategjike dhe miraton aktet për administrimin efikas të institucionit. Këshilli Drejtues përbëhet nga pesë anëtarë, të emëruar nga Autoriteti Mbikëqyrës, që është Banka e Shqipërisë. Dy anëtarë propozohen nga Autoriteti Mbikëqyrës, dy anëtarë propozohen nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë dhe një anëtar propozohet nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar. Anëtarët e Këshillit Drejtues janë jo ekzekutivë, me përjashtim të anëtarit që emërohet në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm. Ligji përcakton se afati i qëndrimit në detyrë për çdo anëtar të Këshillit Drejtues është pesë vjet, me të drejtë rizgjedhje.


Veprimtaria e ASD-së auditohet nga auditues të brendshëm dhe të jashtëm të pavarur, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare në fushën e auditimit.



► Pjesë e rrjetit të sigurisë financiare

Rrjeti i sigurisë financiare në Shqipëri është ngritur me qëllim ushtrimin e përgjegjësive për sigurimin e stabilitetit financiar të vendit, përmes konsultimit dhe koordinimit të veprimeve, duke pasur si objektiva kryesorë parandalimin dhe administrimin e rreziqeve sistemike.


Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar (GKSF) kryen funksionet e rrjetit të sigurisë financiare në Shqipëri. Institucionet anëtare të GKSF-së janë Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave.




Çfarë bën ASD-ja

ASD-ja, duke administruar skemën e sigurimit të depozitave, mbron depozituesit, duke kompensuar depozitat e siguruara në rastet kur një bankë apo shkk falimenton (ngjarje sigurimi). Për këtë qëllim, ASD-ja ka krijuar dhe menaxhon fondet për sigurimin e depozitave, të cilat financohen nga primet e sigurimit të depozitave që paguhen nga institucionet financiare anëtare të skemës së sigurimit të depozitave (banka dhe shkk).

Bashkëpunimi, në rast ngjarjeje sigurimi, përfshin disa institucione shtetërore, si dhe subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave. Qëllimi i këtij ndërveprimi është mbrojtja e depozitave të siguruara të depozituesve dhe ruajtja e stabilitetit financiar në vend.





Çfarë siguron ASD-ja

► Anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave

Si administruese e skemës së sigurimit të depozitave në Shqipëri, ASD-ja siguron depozitat e të gjitha institucioneve financiare që sipas ligjit, u lejohej të mbledhin depozita nga qytetarët. Këtë aktivitetet mund ta ushtrojnë bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit, të licencuara për këtë qëllim nga Banka e Shqipërisë. Anëtarësimi në skemën e sigurimit të depozitave për të gjitha këto institucione financiare është i detyrueshëm. Aktualisht, skema e sigurimit të depozitave në Shqipëri përfshin 12 banka dhe 9 shoqëri kursim-krediti.

► Produktet që mbulohen me sigurim nga ASD

Përgjithësisht, ASD-ja siguron të gjitha llojet e depozitave të depozituesve. Depozituesit nuk kanë asnjë kosto për sigurimin e depozitave të tyre. Bankat dhe shkk-të kanë detyrimin ligjor të paguajnë për sigurimin e depozitave pranë Agjencisë. Gjithsesi ekzistojnë përjashtime për disa kategori specifike depozitash dhe depozituesish, të cilat nuk sigurohen dhe nuk kompensohen. Për informacion më të detajuar në lidhje me këtë seksion, ju lutem vizitoni www.asd.gov.al.



► Niveli i mbulimit sipas ligjit.

ASD-ja siguron dhe kompenson çdo depozitues, në çdo bankë apo shoqëri kursim-krediti (shkk) deri në nivelin maksimal të përcaktuar nga ligji.

Për depozituesit në banka, niveli i përcaktuar i sigurimit dhe kompensimit, në rast se banka është në pamundësi financiare, është deri në 2.500.000 lekë, përfshirë principalin dhe interesin.



Ndërkohë që për depozituesit në shoqëritë e kursim-kreditit (shkk) ky nivel është përcaktuar deri në 2.000.000 lekë, përfshirë principalin dhe interesin.

Çdo depozitues do të thotë jo vetëm depozituesit individë, por edhe tregtarët dhe shoqëritë tregtare.


Nëse një depozitues ka më shumë se një llogari në të njëjtin subjekt anëtar të skemës së sigurimit të depozitave (bankë apo shkk), në rast kompensimi, të gjitha llogaritë do të mbliqen bashkë dhe depozituesi do të rimbursohet deri në nivelin maksimal të mbulimit. Të gjitha degët e institucioneve financiare, që janë anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, përmbajnë të afishuar logon e ASD-së.

Fondet e administruara nga ASD-ja


ASD-ja administron tri fonde, Fondin e Sigurimit të Depozitave në Banka, Fondin e Sigurimit të Depozitave në Shoqëritë e Kursim-Kreditit dhe Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Fondi i Sigurimit të Depozitave në Banka funksionon që prej krijimit të ASD-së. Të gjitha bankat që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, kontribuojnë në këtë fond, duke paguar kontributet fillestare dhe primin tremujor për depozitat që përcaktohen nga Ligji “Për sigurimin e depozitave”. ASD-ja i investon fondet e mbledhura duke rritur fondin. Aktiviteti investues i ASD-së kryhet duke u bazuar në dy parime kryesore: atë të sigurisë dhe likuiditetit.

Fondi i sigurimit të depozitave në banka




Raporti i mbulimit në banka




Fondi i Sigurimit të Depozitave në Shoqëritë e Kursim-Kreditit u krijua në vitin 2017, pasi këto subjekte financiare u bënë pjesë e skemës së sigurimit të depozitave në vitin 2015. Ky fond, i cili financohet nga kapitali dhe kontributet fillestare, primet e shoqërive të kursim-kreditit dhe investimet e kryera nga ASD-ja, administrohet me të njëjtat parime si Fondi i Sigurimit të Depozitave në Banka.

Fondi i sigurimit të depozitave në SHKK



Raporti i mbulimit në SHKK



* Raporti i mbulimit tregon përqindjen e depozitave të siguruar të sistemit bankar/shkk-ve, që mbuloheh nga fondi i sigurimit të depozitave.

* Parashikim fundviti 2022

Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme u krijua në vitin 2018. Fondi duhet të plotësohet gradualisht dhe të arrijë nivelin e synuar deri në vitin 2027. Për të përmbushur këtë nivel, sektori bankar paguan çdo vit një kontribut vjetor. Banka e Shqipërisë, si Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, miraton përdorimin e Fondit. ASD-ja, në rolin ligjor të administratorit të Fondit, zbaton politikën e investimit të Fondit FNJ, sipas rregullave të miratuara nga Banka e Shqipërisë.

ASD në rrafshin ndërkombëtar

► Pjesëmarrja në organizatat ndërkombëtare

ASD-ja, që prej themelimit të saj, është anëtare me të drejta të plota e organizatave ndërkombëtare në fushën e sigurimit të depozitave, IADI dhe EFDI. ASD-ja merr pjesë në aktivitetet e organizuara nga këta organizma, si dhe ka ofruar kontributin e saj në vendimmarrjen dhe përcaktimin e politikave, si pjesë e strukturave drejtuese apo e grupeve të ndryshme të punës, dhe si organizatore e takimeve dhe seminareve teknike, me qëllim përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare për një administrim sa më efikas të skemës së sigurimit të depozitave.



► Bashkëpunimi ndërkombëtar

ASD-ja ka vendosur marrëdhënie të ngushta me rreth 10 institucione të sigurimit të depozitave, kryesisht në Europë, por edhe më gjerë. Marrëveshjet e bashkëpunimit janë lidhur me autoritete të sigurimit të depozitave të atyre vendeve evropiane, industria bankare e të cilave është e pranishme përmes filialeve në sistemin bankar shqiptar, me të gjitha autoritetet e sigurimit të depozitave të Ballkanit, si dhe me sigurues depozitash ndërkombëtarë, të cilët konsiderohen si modele në administrimin efikas të skemës së sigurimit të depozitave.



KOREJA E JUGUT

AGJENCIA
E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE

ASD
VJET

+355 42 362 989
+355 42 347 298

info@asd.gov.al
www.asd.gov.al

Rruga e Elbasanit,
nr.317, Tiranë